



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 06, dt. 30.06.2021

MBI MIRATIMIN E FONDEVE PËR PJESËMARJEN E GRUPIT FOLKLORIK TË QARKUT NË FESTIVALIN FOLKLORIK TIPOLOGJIK KOMBËTAR TË VALLES BURIMORE LUSHNJË 2021

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 09 date 18.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2021”, shkresën e Ministrisë së Kulturës, Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale nr. 179 prot datë 02.06.2021, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratoje fondet për pjesëmarrjen e Grupit Folklorik të Qarkut në Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore Burimore Lushnjë Qershor 2021, sipas Projektit Kulturor bashkëngjitur.
2. Fondi i nevojshëm për financimin e këtij aktiviteti prej 208.000 lekë do të përdoret nga buxheti i Këshillit të Qarkut për vitin 2021 brenda zërit “shpenzime operative” të planifikuara për aktivitete.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, Komisioni organizativ i aktivitetit, Dega e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sek.K.qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Projekt Kulturor

Per pjesemarjen e Grupit Folklorik te Qarkut ne Festivalin Folklorik Tipologjik Kombetar te Valles Popullore Burimore Lushnje Qershor 2021

Ministria e Kulturës, Qendra Kombetare e Veprimtarive Tradicionale organizojne Edicionin e XI te Festivalit Folklorik Tipologjik Kombetar te Valles Popullore Burimore. Kjo veprimatri do te organizohet ne qytetin e Lushnjes dhe ben pjese ne aktivitetet kombetare te parashikuara per tu zhvilluar gjate ketij viti.

Keshilli I Qarkut do te mare pjese ne kete Edicion me nje grup te zgjedhur per interpretimin e valleve më karakteristike burimore te treves se Rajonit.

QELLIMI

Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore, të folkut shqiptar të kësaj trashëgimie që nuk shteron kurrë.

OBJEKTIVAT

- Njohja e vlerave të trashëgimisë kulturore brenda Rajonit.
- Hulumtimi dhe gjetja e materialeve folklorike të rajonit të Korçës me qëllim ruajtjen dhe trasmetimin në brezat që vijnë.
- Vendosja e kontakteve të rregullta dhe sistematike midis grupeve artistike në rafshin rajonal dhe më gjërë.
- Propogandimi i veshjeve popullore të zonave të ndryshme të Rajonit të Korçës.

MOTIVET

- Festivalit Folklorik Tipologjik Kombetar te Valles Popullore Burimore është nje event rëndësishëm në fushën e trashëgimisë kulturore, shpirtërore në rafshin Rajonal dhe Kombëtar.
- Interesim i madh i komunitetit të Rajonit të Korçës dhe përvoja e fituar nga specialistët në fushën e trashëgimise kulturore si dhe nga drejtuesit e pushtetit vendor.

KRITERET SHKENCORE TE FFTK TE VALLES POPULLORE BURIMORE

- Në festival do të marrin pjesë grupe përfaqësuese të Qarqeve dhe të Shoqërive Kulturore Artistike.
- Repertori duhet të përmbajë valle nga të gjitha gjinitë: epike, lirike, burrash, grash, të perzjera, të kënduara dhe të shoqëruara me instrumenta tradicionale.
- Te synohet sjellja e krijimeve të mirefillta duke shmangur krijimet e stlizuara.
- Formacionet orkestrale të kenë në përbërjen e tyre vegla të mirëfillta popullore, të cilat kanë shoqëruar tradicionalisht vallet , këngët apo meloditë fshatare dhe qytetare.
- Valltaret dhe instrumentistët të prezantohen me veshje të traditës të origjines te valles.
- Do të vleresohen grupet që do të përfshijnë në programin e tyre edhe ritual të vjetra.
- Grupi pjesëmarrës në këtë festival do të ketë në përberje valletare, orkestrinën dhe stafin mbështetës me një numër të kufizuar deri në 22 persona. Shpenzimet e fjetjes dhe ushqimit për ditët e qëndrimit në Festival do të përballohen nga organizatorët. Pjesëtarët e grupit mbi 22 do të akomodohen me financim nga fondi I Këshillit të Qarkut I miratuar për këtë aktivitet. Shpenzimet e përgatitjes, udhëtimit dhe honoraret për organizatorët dhe pjesëmarrësit do të financohen me fondet e Këshillit të Qarkut të akorduara për këtë aktivitet.

STRUKTURA E BUXHETIT

- I. Fondi për honorare për stafin organizativ të Festivalit.
- II. Fondi për shpenzime transporti të Grupit Korce - Lushnje dhe kthim si dhe qëndrim në dispozicion për një natë.
- III. Fondi për promovim.
- IV. Fondi për honoraret e artistëve pjesëmarrës.
- V. Fondi për udhëtim dhe diete për anëtarët e stafit organizativ.

PREVENTIVI

Për paraqitje në Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore Burimore, Lushnje Qershor 2021 dhe për shkak të numrit të kufizuar të pjesëmarrësve janë ftuar të marrin pjesë, këngëtarë, valltarë, instrumentistët më të talentuar nga zonat e Devollit dhe Korçës . Bazuar në

kriteret shkencore dhe organizative te festivalit Grupi Folklorik i Qarkut do te perbehet 22 artiste dhe staf mbeshtetes.

- I. Fondi per honorare per Stafin organizativ dhe artistet per punen pergatitore dhe pjesemarjen ne Festival per 22 persona 133000 leke sipas listet bashkengjitur.
- II. Fondi per shpenzime transporti te grupit folkloric Korce – Bilisht - Lushnje dhe kthim, qendrim ne dispozicion per nje nate per 22 persona 60000 leke.
- III. Fondi per prmocion (dizenjim dhe printim fletepalosje me programin e koncertit) Fondi limit 15000 leke


Totali i preventivit

208.000 leke

Fondi prej 208.000 lek do te perballohet nga Buxheti i Keshillit te Qarkut i miratuar per aktivitete dhe transport te grupit folklorik.

Komisioni organizativ

Edi Qirinxhi



Paola Stefanllari



Johana Hajderlli



Korce, me 07.06.2021